



Shqipëria investon në armë, paga dhe kapacitete luftarake

Buxheti 2026 rrit investimet dhe modernizon Forcat Armatosura

» faqe 3



FORMIMI I USHTARIT TË SOTËM DHE TË NESËRM: HISTORIA DHE FUNKSIONIMI I QAPU-së

Qendra e Arsimit Profesional të Ushtarëve: Historia, Struktura dhe Vizioni i Trajnimit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Qendra e Arsimit Profesional të Ushtarëve (QAPU) përfaqëson një institucion kyç për përgatitjen, trajnimin dhe zhvillimin e personelit ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). Historia, zhvillimi dhe modernizimi i saj pasqyrojnë përkushtimin...

faqe 6



REGJIMENTI I KËMBËSORISË SË VERIUT NIS MISIONIN PAQERUAJTËS "ALTHEA" NË BOSNJE-HERCEGOVINË

Në ambientet e Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut të Vau-Dejës u zhvillua ceremonia e përcjelljes së kontingjentit të tretë shqiptar, i cili do të shërbejë në misionin paqeruajtës të Bashkimit Europian EUFOR, në kuadër të operacionit "ALTHEA", në Sarajevë, Bosnje e Hercegovinë. Kontingjenti shqiptar do të jetë pjesë e batalionit multinacional, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në rajon. Në ceremoni morën pjesë drejtues të RKV-së...

faqe 4



LOT NË SALLËN EVROPIANE: DËSHMIA E ROMAN OLEKSIV, FËMIJA QË I MBIJETOI RAKETËS DHE I FOLI NDËRGJEGJES SË EVROPËS

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Më 14 korrik 2022, një ditë vere në Vinitjsja nisi si shumë të tjera. Roman dhe nëna e tij, Halyna Oleksiv, kishin dalë për një shëtitje në qendër të qytetit. Vinitjsja nuk ishte vijë fronti. Ishte një qytet i qetë në Ukrainën qendrore, larg përplasjes direkte ushtarake. Pikërisht kjo e bën edhe më tronditës sulmin...

faqe 5

Pas një seance maratonë, Kuvendi i Shqipërisë miratoi me 84 vota pro, 10 kundër dhe pa asnjë abstenim projektligjin “Për importin, eksportin dhe tranzitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve”.

Nisma ligjore synon forcimin e kuadrit rregullator të Industrisë së Mbrojtjes dhe rritjen e kontrollit mbi mallrat me përdorim të dyfishtë, civil dhe ushtarak.

Gjatë prezantimit në seancën plenare, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, theksoi se projektligji është pjesë e një pakete më të gjerë reformash ligjore:

“Përmes mekanizmave të parashikuar synojmë të garantojmë integritetin e të gjithë zinxhirit: nga prodhimi, tregtimi, eksporti e deri te tranziti i armëve të zjarrit, duke rritur sigurinë, transparencën dhe bashkëveprimin e institucioneve ligjzbatuese”, - deklaroi ministri Vengu.

Sipas ministrit, ligji është tërësisht i ri dhe transponon plotësisht rregulloren e Bashkimit Evropian, duke e vendosur Shqipërinë në të njëjtin standard ligjor me vendet anëtare në një fushë kyçe për sigurinë publike dhe kombëtare. Ai nënvizoi se projektligji forcon mekanizmin e kontrollit shtetëror pa krijuar institucione të reja, duke u mbështetur në përvojën 17-vjeçare të Autoritetit Shtetëror të Kontrollit të Eksporteve.

Një nga risitë kryesore është krijimi i një mekanizmi elektronik licencimi, të sigurt dhe të enkriptuar, që pritet të rrisë mbrojtjen e të dhënave dhe efikasitetin e autorizimeve. Ligji parashikon gjithashtu rritjen e bashkëpunimit mes agjencive ligjzbatuese dhe ngritjen e një baze të dhënash unike ndërinstytucionale, duke mundësuar gjurmueshmëri të avancuar për çdo armë zjarri, si dhe kontrole para dhe pas dërgesës.

Ministri Vengu theksoi se projektligji nuk sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit dhe do të zbatohet nga kapacitetet ekzistuese institucionale:

“Projektligji është pjesë e piketave ndërmjetëse në procesin e negociatave me Bashkimin Evropian dhe përfaqëson një hap të matshëm drejt përmbushjes së tyre”, - shtoi ministri, duke falënderuar komisionet parlamentare që e mbështetën nismën në frymë konsensuale.

Me këtë projektligj, Shqipëria forcon një hap kyç në rritjen e sigurisë kombëtare dhe modernizimin e kuadrit ligjor në fushën e armëve të zjarrit dhe mallrave me përdorim të dyfishtë.



Siguri dhe transparencë: Projektligji për armët merr dritën jeshile në Parlament



Efektivët e Batalionit Komando, pjesëmarrës në stërvitjen ndërkombëtare “KFOR-36” në Gjermani

Efektivë të Batalionit Komando të Forcave të Armatosura shqiptare morën pjesë në stërvitjen paradislokuese ndërkombëtare “KFOR-36”, e cila u zhvillua në qendrën ushtarake të Hohenfels, Gjermani. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte rritja e ndërveprueshmërisë operacionale me partnerët ndërkombëtarë, duke u fokusuar kryesisht në menaxhimin e turmave dhe trazirave gjatë misioneve paqeruajtëse dhe operacioneve të bashkëpunimit. Pjesëmarrja e forcave shqiptare në “KFOR-36” synon gjithashtu forcimin e kapaciteteve profesionale dhe bashkëpunimin me strukturat ushtarake të NATO-s, duke kontribuar në standardizimin e procedurave dhe taktikat operative sipas normave ndërkombëtare.

Stërvitjet e tilla janë pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të Shqipërisë për pjesëmarrje aktive në operacionet paqeruajtëse dhe për përmirësimin e aftësive të Forcave të Armatosura në skenarë komplekse ndërkombëtare.



Shqipëria investon në armë, paga dhe kapacitete luftarake

Buxheti 2026 rrit investimet dhe modernizon Forcat e Armatosura

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, deklaroi gjatë një konference për mediat se **Shqipëria po hyn në një fazë të re të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes**, në një realitet gjeopolitik ku paqja nuk mund të merret më si e mirëqenë, por kërkon **investime konkrete në kapacitete reale shtetërore**.

Duke iu referuar zhvillimeve të fundit ndërkombëtare dhe rolit të Ballkanit në arkitekturën e sigurisë evropiane, ministri Vengu theksoi se **rajoni përballet me forma të reja kërcënimesh**, ndërsa Shqipëria po përgatit aktualisht edhe **Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes**, si një dokument kyç për orientimin afatmesëm dhe afatgjatë të Forcave të Armatosura.

Buxheti 2026 – nga shpenzim në investim strategjik

Ministri i Mbrojtjes vuri në dukje se **Buxheti i Mbrojtjes për vitin 2026 nuk është një buxhet rutinë**, por një instrument strategjik që synon ndërtimin e kapaciteteve reale ushtarake, zhvillimin e industrisë së mbrojtjes dhe forcimin e sovranitetit kombëtar, përfshirë edhe dimensionin dixhital.

“Buxheti i 2026 nuk është një buxhet paqeje romantike. Është një buxhet i përballjes së menaxhuar dhe i sovranitetit kombëtar. Me këtë buxhet, Shqipëria konsolidohet si një aleate e qëndrueshme dhe e besueshme në NATO”, – u shpreh ministri Vengu.

Sipas tij, për herë të parë Shqipëria arrin nivelin 2.12% të Prodhimit të Brendshëm Bruto për mbrojtjen, duke shënuar një rritje prej 12% krahasuar me buxhetin e vitit 2025.

Investim te kapitali njerëzor, themeli i ushtrisë moderne

Një nga shtyllat kryesore të reformës në mbrojtje mbetet **investimi te personeli i Forcave të Armatosura**. Ministri Vengu e cilësoi kapitalin njerëzor si themelin e çdo ushtrie moderne dhe bëri të ditur se **pagat e ushtarakëve do të rriten ndjeshëm në mënyrë progresive**.

“Synimi ynë është që deri në vitin 2029 të arrijmë mesataren e NATO-s. Rritja parashikon 60–70% për pagat bazë dhe rreth 30% për nivelet e larta të komandimit”, – theksoi ai.

Po ashtu, ministri njoftoi se **komponenti aktiv i Forcave të Armatosura do të rritet me rreth 30%**, duke garantuar më shumë forca profesionale dhe një nivel më të lartë gatishmërie operationale.

Modernizim dhe rikthim kapacitetesh të munguara

Ministri Vengu nënvizoi se **50% e Buxhetit të Mbrojtjes përbëhet nga investime**, dhe jo shpenzime, duke u fokusuar drejtpërdrejt në modernizimin e kapaciteteve ushtarake.

Sipas tij, Forcat e Armatosura po rikthejnë kapacitete që kanë munguar prej dekadash:

- Rikthim i plotë i gatishmërisë në **Forcën Ajrore** dhe flotën e helikopterëve;
- Rritje e ndjeshme e kapaciteteve dhe e flotës së **Forcës Detare**, përfshirë mjete të reja dhe investime në rinovimin e mjeteve ekzistuese;
- Investime domethënëse në **Forcën Tokësore**, përfshirë sistemet antitank **“Javelin”**;
- Rikthimi i **kapaciteteve kundërajrore** gjatë vitit 2026, pas dekadash mungese.



Industria ushtarake, investim në sovranitet

Një element thelbësor i strategjisë së re të mbrojtjes është **zhvillimi i industrisë ushtarake vendase**. Ministri Vengu theksoi se kjo industri shihet si një investim i drejtpërdrejtë në sovranitetin teknologjik dhe ekonomik të vendit.

Në lidhje me kompaninë shtetërore **KAYO**, ministri bëri të ditur se ajo ka nisur tashmë aktivitetin prodhues, duke nënshkruar në vitin 2025 **gjashtë marrëveshje shtet-privat**, që përfshijnë prodhimin e:

- armatimit të lehtë,
- municioneve,
- mjeteve të blinduara,
- mjeteve për emergjencat civile,
- uniformave,
- dronëve dhe sistemeve antidron.

Gjithashtu, ai informoi se është në fazë përfundimtare një negociatë e rëndësishme me gjigantin italian



“Fincantieri” për prodhimin e anijeve në Pashaliman.

Sipas ministrit, aktiviteti industrial ka nisur tashmë me linjat e para të prodhimit dhe rekrutimet fillestare: **50 punonjës janë rekrutuar**, ndërsa gjatë këtij viti pritet të punësohen **326 persona**. Këto investime parashikohet të gjenerojnë **3.8 milionë euro të ardhura direkte** dhe rreth **8 milionë euro të ardhura indirekte** për ekonominë.

Shqipëria, rol në rritje në NATO dhe BE

Ministri Vengu theksoi se **Shqipëria po rrit ndjeshëm kontributin e saj në misionet ndërkombëtare**. Gjatë vitit 2025, më shumë se **700 efektivë shqiptarë** kanë qenë të angazhuar në misione të NATO-s dhe BE-së, një kontribut që, sipas tij, do të vijojë të rritet edhe në vitet në vijim.

Në këtë dalje për mediat, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu shoqërohej nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, Drejtori i AKMC-së, Haki Çako, si dhe Drejtori i Agjencisë për Industrinë e Mbrojtjes, Dorian Tola.



Forcat Speciale në aksion dimëror: ‘Shigjeta Ilire-26’ sfidon dëborën dhe temperaturat nën zero

Efektivët e Batalionit të Forcave Speciale po zhvillojnë stërvitjen dimërore 72-orëshe “Shigjeta Ilire-26”, në kushte të vështira malore, me dëborë dhe temperatura nën zero.

Kjo stërvitje ka për qëllim forcimin e aftësive fizike dhe psikologjike në kushte mbijetese, testimin e armatimit dhe pajisjeve të reja, si dhe rritjen e gatishmërisë dhe qëndrueshmërisë operacionale për të operuar në mjedise të vështira.

Efektivët po praktikojnë manovra komplekse dhe teknike mbi mbijetesën në kushte ekstreme, duke u përgatitur për përmbushjen me sukses të çdo misioni, me profesionalizëm të lartë dhe koordinim maksimal.

Stërvitja “Shigjeta Ilire-26” është pjesë e programit të trajnimeve intensive të Forcave Speciale, që synon të rrisë kapacitetet operative dhe përgatitjen për situata kritike në çdo skenar operativ.



Regjimenti i Këmbësores së Veriut nis misionin paqeruajtës “ALTHEA” në Bosnje-Hercegovinë

Kontingjenti i tretë i Forcës Tokësore drejt operacionit paqeruajtës të Bashkimit European

Në ambientet e Regjimentit të Këmbësores së Veriut të Vau-Dejës u zhvillua ceremonia e përcjelljes së kontingjentit të tretë shqiptar, i cili do të shërbejë në misionin paqeruajtës të Bashkimit European EUPOR, në kuadër të operacionit “ALTHEA”, në Sarajevë, Bosnje e Hercegovinë.

Kontingjenti shqiptar do të jetë pjesë e batalionit multinacional, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në rajon.

Në ceremoni morën pjesë drejtues të RKV-së, familjarë të efektivëve dhe pjesëtarë të Forcës Tokësore. Në mbyllje të aktivitetit u lexua mesazhi i Komandantit të Forcës Tokësore, Gjeneralmajor Petrit Çuni, i cili vlerësoi kontributin, angazhimin dhe përkushtimin e efektivëve të Forcës Tokësore në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare.

Ky kontingjent përfaqëson një hap të rëndësishëm në angazhimin e Shqipërisë për paqe dhe siguri ndërkombëtare, duke demonstruar gatishmërinë dhe profesionalizmin e Forcave të Armatosura shqiptare në skenarë operativë ndërkombëtarë.



23 vite shërbim dhe profesionalizëm: BrSB, shtylla e arsimit ushtarak

Në ambientet e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarëve (QAPU) u kremtua 23-vjetori i krijimit të Brigadës së Stërvitjes Bazë (BrSB), një institucion kyç në formimin profesional, trajnimin dhe arsimimin e brezave të ushtarëve gjatë këtyre viteve.



BrSB ka luajtur një rol të veçantë në përgatitjen e ushtarëve me standarde të larta profesionale, duke siguruar njohuri, disiplinë dhe vlera që garantojnë vazhdimësinë e shërbimit ushtarak me cilësi.

Ceremonia e kremtimit theksoi 23 vite përkushtim, profesionalizëm dhe shërbim ndaj Atdheut, duke reflektuar arritjet e Brigadës në ngritjen e kapaciteteve të reja dhe përgatitjen e brezave të rinj të Forcave të Armatosura.

QAPU dhe BrSB mbeten shtylla kryesore e arsimit profesional ushtarak, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve operative dhe ruajtjen e traditës së lartë të shërbimit ndaj vendit.



Lot në Sallën Evropiane: Dëshmia e Roman Oleksiv, fëmija që i mbijetoi raketës dhe i foli ndërgjegjes së Evropës

Nga plagët e Vinitsjas te heshtja që shpërtheu në lot në Parlamentin Evropian



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Një sulm, një jetë e thyer, një fëmijëri e djegur

Më 14 korrik 2022, një ditë vere në Vinitsja nisi si shumë të tjera. Roman dhe nëna e tij, Halyna Oleksiv, kishin dalë për një shëtitje në qendër të qytetit. Vinitsja nuk ishte vijë fronti. Ishte një qytet i qetë në Ukrainën qendrore, larg përplasjes direkte ushtarake. Pikërisht kjo e bën edhe më tronditës sulmin.

Tre raketa ruse 'Kalibr' goditën zonën civile. Njëra prej tyre shpërtheu pranë Shtëpisë së Oficerëve, ku ndodheshin edhe fëmijë, prindër, kalimtarë të rastit. Brenda sekondave, qetësia u shndërrua në flakë, tym dhe britma.

Halyna u vra në vend. Roman u gjet i gjallë, por i djegur rëndë, me plagë të shumta, trupin e mbuluar nga shenjat e shkatërrimit. Mjekët do të thoshin më vonë se mbijetesa e tij ishte mrekulli.



36 operacione dhe një betejë për çdo frymëmarrje

Roman kaloi muaj të tërë në spitale. Trupi i tij u nënshtrua **36 operacioneve kirurgjikale**, ndërhyrje të dhimbshme për të shpëtuar jo vetëm jetën, por edhe funksionet bazë të trupit. Djegiet e shkallës së tretë, dëmtimet në fytyrë, duar dhe këmbë, e kthyen çdo ditë në një luftë të re.

Rehabilitimi ishte po aq i ashpër. Dhimbja fizike shoqërohej nga trauma psikologjike: humbja e nënës, kujtimet e shpërthimit, frika nga zhurmat, nga flakët, nga errësira. Një fëmijë që duhet të mendonte për lojëra dhe shkollë, mëson të duronte dhimbjen dhe të jetonte me mungesën.

Një fëmijë që u kthye në shkollë, jo në urrejtje

Megjithatë, historia e Romanit nuk është vetëm histori vuajtjeje. Është histori rezistence. Pas muajsh trajtimi, ai u kthye në shkollë. Me plagë të dukshme, me trup të ndryshuar, por me një vendosmëri që i habiti edhe mjekët.

Në sallën solemne të Parlamentit Evropian, ku zakonisht mbizotëron gjuha e ftohtë e diplomacisë, statistikave dhe fjalimet e kalkuluara, atë ditë heshtja kishte një peshë tjetër. Nuk ishte heshtje procedurale. Ishte heshtje njerëzore. Një heshtje që u thyer jo nga zhurma e debateve politike, por nga zëri i një fëmije, një zë i vogël, i thyer, por i mbushur me një forcë që rrallë dëgjohej në sallat e pushtetit. Roman Oleksiv, vetëm 11 vjeç, qëndronte përballë përfaqësuesve më të lartë të Evropës, jo si simbol abstrakt i luftës, por si dëshmi e gjallë e saj. Trupi i tij mbante shenjat e raketës ruse që goditi qytetin ukrainas të Vinitsjas në korrik të vitit 2022. Zëri i tij mbante mungesën e nënës. Dhe historia e tij mbante barrën morale të një kontinenti që po shikonte luftën përmes ekraneve.



Presidenti i Ukrainës e nderoi Roman Oleksivin me një çmim për guxim dhe qëndrueshmëri. Por vetë Roman, në fjalët e tij, nuk foli për heroizëm. Ai foli për nënën. Për dëshirën që lufta të ndalet. Për fëmijët që nuk duhet të përjetojnë atë që ai përjetoi.

Dokumentari dhe momenti që theu protokollin evropian

Në Parlamentin Evropian u shfaq një dokumentar kushtuar fëmijëve ukrainas të prekur nga lufta. Pamjet ishin të forta, por asgjë nuk përgatiti sallën për momentin kur Roman mori fjalën.

Teksa fliste, asistentja e njërit prej nënkryetarëve të Parlamentit Evropian përkthente fjalët e tij. Zëri i saj u drodh. Sytë u mbushën me lot. Ajo nuk arriti ta fshehë emocionin. Protokollin e shemb. Përkthimi u bë njerëzor, jo teknik.

Lotët e saj u bënë simbol i asaj që shpesh mungon në politikë: empatia reale.

"Unë nuk dua që fëmijët e tjerë të humbasin nënat e tyre"

Roman nuk kërkoi hakmarrje. Nuk kërkoi armë. Nuk kërkoi dënime. Ai kërkoi ndalim. Ndalesë të luftës. Mbrojtje për fëmijët.

Në sallë kishte deputetë që kishin votuar sanksione, rezoluta, paketa ndihme. Por përballë Romanit, të gjitha këto u dukën të pamjaftueshme.

Sepse për herë të parë, pas shifrave të raporteve, kishte një fytyrë. Një zë. Një fëmijë.

Dëshmia si akt politik dhe moral

Dëshmia e Roman Oleksivit nuk ishte thjesht rrëfim personal. Ishte akt politik në kuptimin më të thellë të fjalës. Ai e ktheu luftën nga koncept gjeopolitik në realitet njerëzor. Ai e zhveshi Evropën nga komoditeti i distancës.

Në historinë e Parlamenteve, rrallëherë një fëmijë ka arritur të bëjë atë që shpesh nuk e bëjnë diplomatët: të detyrojë një sallë të tërë të ndiejë.

Evropa përballë pasqyrës së saj

Lotët e asaj përkthyesë nuk ishin dobësi. Ishin dëshmi se njerëzimi ende ekziston brenda institucioneve. Por pyetja që mbetet është: **a do të shndërrohet ky emocion në veprim?**

Roman u kthye në Ukrainë. Lufta vazhdon. Fëmijë të tjerë ende humbasin prindërit e tyre. Dhe dëshmia e tij qëndron si një thirrje e hapur për ndërgjegjen evropiane dhe botërore.

Një fëmijë, një nënë, një kontinent

Historia e Roman Oleksivit është histori e një fëmije që humbi gjithçka, përveç dinjitetit. Është histori e një nëne që nuk arriti të mbrojë djalin e saj nga raketat. Është histori e një kontinenti që po mëson, ndoshta me vonë, se lufta nuk është lajm, është plagë.

Dhe sa herë që politika harron këtë, mjafton zëri i një fëmije për ta kujtuar.



Formimi i Ushtarit të Sotëm dhe të Nesërm: Historia dhe Funksimi i QAPU-së

Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve: Historia, Struktura dhe Vizioni i Trajnimit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve (QAPU) përfaqëson një institucion kyç për përgatitjen, trajnimin dhe zhvillimin e personelit ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). Historia, zhvillimi dhe modernizimi i saj pasqyrojnë përkushtimin e institucioneve të mbrojtjes kombëtare dhe vizionin strategjik për formimin e ushtarit profesionist, të aftë të përmbushë detyrat operative dhe misionet kombëtare e ndërkombëtare.

Zanafilla dhe periudha e hershme (1964–1990)

- Baza e Bunavisë është krijuar në vitin 1964 si **Batalion Këmbësorie**, duke shërbyer si njësi fillestare për trajnimin e ushtarëve.

- Në periudhën 1985–1990, struktura funksionoi si **Shkollë Instruksioni**, duke përgatitur oficerët e rezervës, duke siguruar një bazë të fortë për profesionalizmin e hershëm.

Periudha e tranzicionit (1991–2003)

- Në vitet 1991–1996, Batalioni u transformua në **Brigadë Këmbësorie**, duke vijuar përgatitjen dhe strukturimin e njësisë operative.

- Midis 1996–2003, struktura funksionoi përsëri si Batalion Këmbësorie.

- Në **shtator 2003**, u krijua **Brigada e Stërvitjes Bazë**, duke vendosur një sistem të centralizuar dhe profesional të trajnimit të rekrutëve.

Evolucioni drejt formës moderne (2003–2020)

- Në vitin 2010, u emërtua **Qendra e Stërvitjes**



Individuale, duke përqendruar trajnimet e rekrutëve dhe ushtarëve aktivë.

- Nga tetori 2012 deri në tetor 2020, struktura funksionoi si **Shkolla e Trupës**, duke konsoliduar programet e stërvitjes bazë dhe të avancuar.

- Nga tetori 2020, struktura ka marrë emrin aktual **Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve (QAPU)**, duke vijuar me misionin e saj përgatitor dhe trajnues të gjithë kontingjentet e rekrutëve dhe ushtarëve të FARSH.

Misioni dhe funksionet e QAPU-së Misioni kryesor

QAPU është institucioni i vetëm ushtarak në Shqipëri që përgatit dhe trajnon të gjithë kandidatët për **ushtarë, detarë dhe oficerë** në FARSH. Misioni i saj përfshin:

- Stërvitjen Individuale Bazë (SIB):** Trajnimi i rekrutëve rishtas, për të zhvilluar disiplinën, aftësitë fizike, njohuritë taktike dhe gatishmërinë operacionale.

- Stërvitjen Individuale të Avancuar (SIA):** Trajnimi i ushtarëve aktivë sipas specialiteteve



(këmbësori, logjistikë, xhenio, ndërlidhje, polici ushtarake, shëndetësi), për t'i përgatitur për misione më komplekse dhe detyra operative deri në nivel skuadre.

Funksionet kryesore

- Drejtimi dhe menaxhimi i programeve të trajnimit për SIB dhe SIA.
- Vlerësimi i performancës së rekrutëve dhe ushtarëve për përmbushjen e standardeve fizike, taktike dhe morale.
- Sigurimi i infrastrukturës stërvitore, materialeve didaktike dhe armatimit për të gjithë programet e trajnimit.
- Përgatitja e personelit për misione kombëtare dhe ndërkombëtare.

Strukturat dhe kapacitetet e QAPU-së

Vendndodhja dhe kapacitetet fizike

- QAPU është e dislokuar në **Bashkinë Vlorë**, njësitë administrative Qendër dhe Shushicë.
- Koordinatat gjeografike: Φ 41°31'10", Λ 19°30'43".
- Kapacitet akomoduese: 500–600 vetë, me ndërtesa të rikonstruara dhe një hotel katërkatësh të ndërtuar në 2007.

Infrastrukturë për jetesë dhe mirëqenie

- Kuzhinë dhe mensa me kapacitet 300 vende, ushqim i siguruar nga kontraktor privat.
- Dushe dhe sisteme larjeje të avancuara, larja e uniformave gjithashtu me kontraktor privat.
- Bibliotekë e pasur, salla televizori, terrene sportive (futboll, volejboll, basketboll, pista vrapimi, kalçeto).

Infrastrukturë stërvitore

- Poligone qitjeje:** për armët e këmbëorisë, granata dore, mitraloza, automatik deri 200m, qitje natën.
- Poligone taktike:** operacione mbrojtëse, sulmuese dhe asimetrike, lufta në qendrat e banuara.
- Terrene fizike:** Brezi i Kalitjes fizike, vegla gjimnastikore, sheshe për trajnim trup më trup.
- Sheshe dhe rajone stërvitore:** për MKK, xhenio, ndërlidhje, topografi, ndërtim struktural dhe taktika rreshtimi.

Kapacitet kurrikular dhe programor

- Programi SIB:** 10 javë (53 ditë stërvitore), përgatit rekrutët për detyra individuale dhe grupore.
- Programi SIA:** 10 javë (50 ditë stërvitore), përgatit ushtarët aktivë për specialitete të avancuara.
- Numri i kursantëve: 3 kurse SIB/vit (156 rekrutë/kurs) dhe 3 kurse SIA/vit (120 ushtarë/kurs), gjithsej 828 të trajnuar në vit.

Armatimi, teknika dhe baza materiale

- Mbështet të gjithë programin e stërvitjes për specialitetet këmbësori, logjistikë, ndërlidhje, xhenio, policia ushtarake, shëndetësi.
- Baza materiale për stërvitje siguron pajisje luftarake, materiale didaktike dhe mbështetje logjistike.
- Poligonet dhe mjediset janë të pajisura sipas



standardeve bashkëkohore për zhvillimin e kompetencave operative.

Personeli dhe instruksioni

- Trupi i instruktorëve ka eksperiencë shumëvjeçare dhe përfaqëson aset profesional dhe të besueshëm.
- Fokus në trajnim individual dhe grupor, duke përdorur metodologji moderne dhe bazuar në standardet e NATO-s.
- Siguron trajtim uniform dhe standard për të gjithë kursantët, përqendruar në një strukturë të specializuar stërvitore.

Vizioni për të ardhmen

- QAPU synon të jetë qendra qendrore për trajnimin e të gjithë rekrutëve dhe ushtarëve profesionistë në FARSH.
- Faza e parë (2–3 vite):** forcimi i strukturës dhe standardeve të trajnimit.
- Faza e dytë (afatmesëm):** modernizimi i infrastrukturës, ndërhyrje në objektet akomoduese dhe poligone.
- Faza e tretë (afatgjatë, 10 vite):** ndërtimi i objekteve të rinj, modernizim i pajisjeve dhe armatimit, konsolidim i kapaciteteve për të ofruar trajnime sipas standardeve ndërkombëtare.
- Vizioni kurrikular përqendrohet në harmonizimin e programeve me kërkesat e reparteve operative, duke pasuruar stërvitjen me eksperiencat e reja të operacioneve të përditshme.

Rëndësia strategjike

QAPU është themeli i formimit profesional të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ajo siguron:

- Formimin e ushtarëve të disiplinuar dhe profesionistë.
 - Standardizimin e trajnimeve sipas kërkesave operative dhe taktike.
 - Një qendër moderne stërvitjeje që mundëson zhvillim të integruar fizik, taktik dhe psikologjik.
- Në kushtet e sfidave të sigurisë kombëtare dhe pjesëmarrjes së Shqipërisë në misione ndërkombëtare, QAPU mbetet një institucion kyç për zhvillimin e kapaciteteve të ushtarëve në profesionistë të ardhshëm.

RIJETËSIMI I INDUSTRISË USHTARAKE SI NJË SFIDË E KOHËS



KOLONEL (R) ARBEN DHULI

Një historik retrospektiv i industrisë ushtarake në Shqipëri

Me shpalljen e pavarësisë në vitin 1912, Shqipëria nisi të ndërtojë institucionet e saj ushtarake kombëtare. Gjatë Mbretërisë së Zogut (1928–1939), ushtria u organizua, por vendi mbeti i varur nga importi i armëve dhe pajisjeve ushtarake, kryesisht nga Italia. Kjo varësi, e kombinuar me mungesën e teknologjisë dhe mobilizimin e dobët, bëri që ushtria shqiptare të mos ishte në gjendje t'i rezistonte pushtimit italian të vitit 1939. Pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria u shndërrua në një shtet totalitar të izoluar, fillimisht aleat me Bashkimin Sovjetik dhe më pas me Kinën. Ushtria dhe industria ushtarake u organizuan mbi logjikën e kontrollit total shtetëror dhe vetëmjaftueshmërisë. Në këtë periudhë u ngritën fabrikat kryesore ushtarake në Mjekës, Gramsh dhe Poliçan, të specializuara në prodhimin e armëve të lehta, municioneve, bombave të aviacionit, minave dhe pajisjeve të tjera ushtarake. Paralelisht, u ndërtua edhe një rrjet i gjerë bunkerësh në territorin shqiptar, të konceptuar si “mburojë” për mbrojtjen e popullsisë, strukturë që sot është bërë pjesë e peizazhit dhe kujtesës kolektive. Megjithëse gjatë viteve '60–'80 industria ushtarake synonte vetëmjaftueshmërinë, teknologjia e përdorur ishte e vjetruar dhe izolimi politik dhe ekonomik kufizonte produktivitetin dhe zhvillimin teknik. Industria e mbrojtjes u ndërtua pothuajse tërësisht në funksion të një modeli vetëmbrojtës dhe në disa raste edhe për eksport në vende të treta, por pa një strategji afatgjatë modernizimi. Me ndryshimin e sistemit totalitar në fillim të viteve '90, kjo industri u përball me një krizë të thellë. Fabrikat që dikur punonin vetëm për ushtrinë humbën porosinë dhe mbështetjen shtetërore. Në vitin 1991 u krijua kompania shtetërore “MEICO”, me mision menaxhimin e armëve të mbetura dhe zhvillimin e ndonjë aktiviteti tregtar ndërkombëtar. Por në dekadat që pasuan, Shqipëria u orientua gjithnjë e më shumë drejt importit të armëve dhe pajisjeve, duke zbehur rolin e prodhimit vendas dhe duke e lënë industrinë e mbrojtjes pa një model të ri të integruar në arkitekturën e sigurisë euroatlantike.

Përpjekjet e ringritjes së industrisë ushtarake dhe tendencat e fundit

Qeveria shqiptare ka miratuar projektligje dhe masa që synojnë në ndërtimin dhe zgjerimin e industrisë së mbrojtjes, fillimin e aktivitetit prodhues si dhe krijimin e mundësive edhe për eksportim të armatimeve. Një nga zhvillimet më të rëndësishme të viteve të fundit është themelimi, në vitin 2024, i shoqërisë shtetërore KAYO sh.a., me mision ringjalljen



e industrisë ushtarake shqiptare. Kjo kompani trashëgon kapacitetet e fabrikave historike të Mjekësit, Gramshit dhe Poliçanit, duke synuar t'i përshtatë ato me kërkesat dhe standardet bashkëkohore. Ndërkohë që projekti “Shota MRAP”, “Made in Albania” automjeti i blinduar i prodhuar nga kompania vendase “Timak” është një prej sinjaleve të para konkrete të ringritjes së industrisë ushtarake. Gjithashtu edhe Kompania “Guna”, për prodhimin e pajisjeve individuale dhe uniformave ushtarake, etj. Gjithashtu, modernizimi i infrastrukturës ushtarake, digjitalizimi, zhvillimi i teknologjive të reja (dronët, elektronikë ushtarake) dhe ndërveprimi me aleatët janë komponentë thelbësorë në këtë strategji të re. Si konkluzion historik mund të themi që Shqipëria ka pasur një industri ushtarake relativisht të zhvilluar gjatë periudhës komuniste, por ajo u degradua pas tranzicionit demokratik. Sot po ndërmerren përpjekje serioze për ta ringjallur atë, me bazë në resurset ekzistuese historike dhe orientim drejt standardeve bashkëkohore, për të mbështetur nevojat kombëtare dhe potencialisht për t'u bërë një aktor eksportues në rajon.

Pse është i domosdoshëm rivitalizimi i industrisë së mbrojtjes?

Domosdoshmëria për të rivitalizuar industrinë ushtarake buron nga një kombinim faktorësh strategjikë, ekonomikë dhe gjeopolitikë. Pas Luftës së Ftohtë dhe rënies së kapaciteteve prodhuese, shumë vende të Ballkanit, përfshirë Shqipërinë, u bënë të varura nga importet për pajisje dhe armatime ushtarake. Rritja e tensioneve në rajon dhe në mjediset përreth NATO-s ka rikthyer në qendër të vëmendjes nevojën për kapacitete vendore të qëndrueshme. Mosmarrëveshjet e pazgjidhura historike në Ballkan, përplasjet e interesave të NATO-s dhe BE-së me ndikimin në rritje të Rusisë, Kinës dhe Iranit, si dhe pasiguria në arkitekturën globale të sigurisë, shtrijnë nevojën për një rishikim të politikave të mbrojtjes. Vendet janë të detyruara të mendojnë jo vetëm për

numrin e trupave dhe armëve, por edhe për zinxhirët e furnizimit, aftësinë për mirëmbajtje dhe prodhim, si dhe pavarësinë strategjike. Në këtë kontekst, për një vend anëtar të NATO-s dhe aspirant për në BE si Shqipëria, rivitalizimi i industrisë ushtarake nuk është thjesht një opsion ekonomik, por pjesë përbërëse e detyrimit për të përmbushur standardet e interoperabilitetit dhe për të kontribuar seriozisht në operacionet e përbashkëta të Aleancës.

Risku i varësisë nga furnizues të vetëm

Varësia e lartë nga furnizues të huaj krijon rreziqe në kohë krizash (si bllokada, embargo, rritje çmimesh etj.). Ndërtimi i kapaciteteve të brendshme ofron mundësi fleksibile si dhe aftësi për reagim të shpejtë në emergjencë. Industria e mbrojtjes vepron si një nxitës për sektorë të tjerë si: mekanikë, elektronikë, teknologji informative dhe inovacion shkencor. Rivitalizimi sjell punësim të kualifikuar, rritje të eksporteve dhe rritje të konkurrueshmërisë së ekonomisë kombëtare. Ai shihet si një ringjallje e potencialit të humbur, i përshtatur me nevojat moderne. Rivitalizimi i industrisë ushtarake është domosdoshmëri për të rritur aftësinë mbrojtëse, për të forcuar pozicionin ndërkombëtar të Shqipërisë dhe për të zhvilluar teknologjikisht dhe ekonomikisht vendin. Nëse rrezikojmë të furnizohemi nga një furnizues i vetëm atëherë investimet do të ekspozohen ndaj ndikimeve të huaja jo të favorshme dhe ndonjëherë kundërshtarë. Furnizimi nga një burim i vetëm ndodh kur një ushtri apo shtet mbështetet tek një prodhues i vetëm (shtetëror apo privat) për një kategori të caktuar armatimi ose municioni (si raketa, predha, dronë, municione të artillerisë, etj.). Kjo quhet “**single-source dependency**” dhe është një pikë e dobët kritike në zinxhirin e furnizimit ushtarak. Furnizimi nga një burim i vetëm është një kërcënim i heshtur, por potencialisht fatal për një ushtri moderne. Në një epokë ku luftërat janë të shpejta, me një teknologji të lartë dhe të paparashikueshme, siguria nuk vjen vetëm nga fuqia e zjarrit, por nga fleksibiliteti dhe

besueshmëria e zinxhirit të furnizimit. Në thelb, armët nuk janë thjesht mallra, por instrumente gjeopolitikë. Kur një shtet furnizues ka monopolin për teknologjinë dhe zinxhirin e furnizimit, ai kontrollon gjithçka. Nuk është hera e parë që bota përballlet me këtë fenomen, pasi Ukraina, në vitet para 2022-it, kishte varësi të madhe nga armatimi sovjetik dhe më vonë nga ndihma perëndimore. Kur furnizimet u vonuan, mbrojtja e saj ra nën presion të madh. Gjithashtu Turqia, një vend anëtar i NATO-s, përjetoi përplasje me SHBA-të për shkak të blerjes së sistemit rakotor rus S-400. Si pasojë, u përjashtua nga programi i blerjes së avionëve luftarakë F-35 dhe përjetoi izolim teknologjik ushtarak. Por që ndërkohë Finlanda dhe Suedia, gjatë periudhave të neutralitetit, investuan qëllimisht në industrinë e tyre të armatimit për të shmangur këtë varësi, një politikë kjo e zgjuar që sot u ka dhënë pavarësi në integrimin në NATO. Për të pasur një ushtri funksionale, nevojitet pavarësi relative në furnizim, planifikim afatgjatë, dhe marrëdhënie të balancuara me partnerët ushtarakë. Në një epokë të pasigurt, siguria vjen nga zgjuarsia, jo nga besimi i verbër.

Roli i AIM-së në Rijetësimin e Industrisë Ushtarake

Rivlerësimi dhe modernizimi i kapaciteteve kombëtare do të fillojë me përditësimin e infrastrukturës së kërkim-zhvillimit, prodhimit, magazinimit dhe logjistikës, sipas standardeve të NATO0-s dhe BE-së. Krijimi ose modernizimi i laboratorëve me pajisje të certifikuara sipas standardeve EN ISO dhe direktivave të BE-së, integrimi i platformave dixhitale për modelim, simulim dhe testim, në përputhje me standardet e NATO-s do të shërbejnë për interoperabilitetin teknologjik. Automatizimi i proceseve prodhuese, zbatimi i mekanizmave të kontrollit dhe optimizimit në përputhje me standardin EN ISO 9001 për menaxhimin e cilësisë dhe me kërkesat e AQAP (Allied Quality Assurance Publications) është faktor kyç për garantimin e cilësisë në sektorin e mbrojtjes. Planifikimi i proceseve, verifikimi, vlefshmëria dhe lidhjet me sistemet e auditimit dhe certifikimit duhet të jenë baza e fillimit të punës. Certifikimi i linjave të prodhimit sipas direktivave të BE-së për sigurinë në industri, si Machinery Directive, ATEX për mjedise me rrezik është një nga kërkesat dhe parimet kryesore që do të ndjekë AIM. Ndërtimi dhe adaptimi i depove sipas rregulloreve AASTP-1 dhe AASTP-5 (NATO standards për ruajtjen e eksplozivëve/municioneve) është një nga kërkesat jo vetëm të sigurisë por edhe të cilësisë së produkteve. Zbatimi i sistemeve inteligjente për gjurmim dhe kontroll të materialeve RFID, platforma digjitale për inventarizim, synohet të jetë baza dhe platforma e punës së AIM bazuar në standardet e vendosura për këtë proces. Në fushën e logjistikës së nevojshme kërkohet, përmirësimi i sistemeve të transportit dhe shpërndarjes sipas rregulloreve ADR/IMDG/IATA për mallrat e rrezikshme dhe Integrimi i standardeve të BE-së për Green Logistics (reduktim të karbonit, efikasitet energjetik). Po kështu në fushën e logjistikës do të synohet për një përshtatje me STANAG (Standardization Agreements) të NATO-s për ndërveprim logjistik dhe zinxhirin e furnizimit. Me këto standarde të vendosura do të arrihet të bëhet e mundur që këto kapacitete të jenë të certifikuara dhe në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar. Për të arritur deri këtu, duhet garantuar përputhshmëria me kuadrin ligjor kombëtar në fuqi, përfshirë aktet nënligjore dhe udhëzimet e institucioneve përgjegjëse. Përfshirja e industrisë ushtarake shqiptare në projekte të përbashkëta ndërkombëtare, është shumë e domosdoshme për të garantuar standardizim të plotë dhe zhvillimin e aftësive për të operuar në mjedise shumëkombëshe, ku Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura janë palë. Licencimet, kontrolltet e

eksporteve dhe certifikimet për kompanitë vendase që ofrojnë produkte ose shërbime në sektorin e mbrojtjes, do të bëhen në përputhje me standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Forcim i kapaciteteve kibernetike dhe mbrojtje nga kërcënimet hibride, do të arrihet me investime në teknologji të sigurisë kibernetike, sisteme paralajmërimi të hershëm dhe protokolle kundër dezinformimit. Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve Pete Hegseth në një fjalim historik, të mbajtur më 1 tetor 2025, deklaroi në prani të gjeneralëve të Ushtrisë amerikane se “Epoka e departamentit të mbrojtjes ka përfunduar, epoka e departamentit të luftës ka filluar”. Kjo deklaratë rezulton të jetë si një kampanë alarmi që duhet të dëgjohet nga e gjithë bota. Kjo është veçanërisht e vërtetë për vende të vogla si vendi ynë, i cili, përballë sfidave të mëdha të sigurisë dhe mungesës së kapaciteteve industriale, ka vetëm një rrugë të qëndrueshme përpara: bashkëpunimi si levë për rijetësimin e industrisë së mbrojtjes.

Zhvillimi i teknologjive të mbrojtjes kërkon investime të mëdha në kërkim dhe zhvillim (R&D), prototipizim dhe testim. Këto kosto janë të papërballueshme për vende të vogla në mënyrë individuale. Partneritetet do ndihmojnë në ndarjen e barrës financiare dhe përfitimin



nga eksperiencia të konsoliduara ndërkombëtare. Për shkak të sfidave të përbashkëta (tensionet etnike, varësia nga importet, mungesa e zinxhirëve lokalë të furnizimit), bashkëpunimi mes vendeve të rajonit tonë përbën një mundësi strategjike. Kroacia dhe Sllovenia për shembull, kanë zhvilluar komponentë për prodhimin e automjeteve të blinduara në bashkëpunim kjo me kompani të mëdha europiane, duke përfshirë edhe partnerë rajonalë më të vegjël. Shqipëria po përpiqet të zhvillojë industrinë e saj të mbrojtjes në mënyrë jo të izoluar, pasi në këtë mënyrë ajo do të shmangë rrezikun e izolimit teknologjik dhe mungesën e standardizimit me partnerët e NATO-s. Shqipëria mund të krijojë një vlerë të shtuar për ekonominë e saj dhe të sigurojë mbrojtje efektive për interesat kombëtare duke u pozicionuar si aktor serioz në arkitekturën e sigurisë në rajon. Bashkëpunimi është, në këtë kontekst, forma më moderne e sovranitetit inteligjent (smart).

Sfida e brezave dhe rindërtimi nga e para

Rijetësimi i industrisë së mbrojtjes në Shqipëri nuk është vetëm një proces teknik apo financiar. Ai

përballet me një sfidë të thellë gjeneratash. Brezi i vjetër i specialistëve që ka punuar në ndërmarrjet ushtarake gjatë periudhës komuniste është në pension ose pranë daljes në pension. Mungesa e transferimit të dijes dhe e shkollave profesionale të specializuara ka krijuar një boshllëk të ndjeshëm.

Ndaj, nuk mjafton thjesht “ringjallja” e një modeli të vjetër. Nevojitet një rindërtim i plotë, me një brez të ri inxhinierësh, teknikësh dhe specialistësh, të formuar në teknologjitë moderne: dronë, sisteme vëzhgimi, elektronikë ushtarake, siguri kibernetike, inteligjencë artificiale për mbrojtje. Kjo kërkon programe specifike universitare dhe profesionale, si dhe politika për “kthimin e trurit”, që të nxisin specialistët shqiptarë në diasporë të kontribuojnë në këtë fushë.

Ndërkohë vendet e vogla si Estonia dhe Kroacia kanë treguar se, nëpërmjet partneriteteve me kompani të huaja dhe fokusit në segmente të caktuara si sistemet kibernetike apo dronët është e mundur të ndërtohet një profil i qëndrueshëm në industrinë e mbrojtjes.

Rijetësimi nuk nënkupton domosdoshmërisht rikthimin te prodhimi klasik i armëve, por mund të fokusohet në teknologji të reja: siguri kibernetike, prodhim pjesësh 3D për dronë, pajisje inteligjente

KURRË MË? – KUJTESA E HOLOKAUSTIT DHE HIPOKRIZIA E SOTME E NDËRGJEGJES NDËRKOMBËTARE

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Holokausti si plagë e hapur e njerëzimit

Sot, bota përkujton Holokaustin, krimin sistematik të nazizmit kundër hebrenjve, romëve, personave me aftësi të kufizuara, kundërshtarëve politikë dhe pakicave të tjera. Një krim i përmasave industriale, i projektuar dhe zbatuar nga një shtet modern, që përdori ligjin, shkencën dhe burokracinë për të shfarosur miliona jetë njerëzore.

Holokausti nuk është thjesht një kapitull i errët i historisë evropiane, ai është një plagë e hapur e vetë ndërgjegjes njerëzore. Për këtë arsye, ai është dënues për ekzistencën nga komuniteti ndërkombëtar dhe është përfshirë në dokumentet themelore të së drejtës ndërkombëtare si shembulli ekstrem i asaj që njerëzimi nuk duhet të lejojë kurrë më.

Për dekada me radhë, Holokausti është shndërruar në busull morale globale. Jo vetëm si kujtesë e dhimbshme e së kaluarës, por si paralajmërim i vazhdueshëm për rrezikun e urrejtjes, racizmit, dehumanizimit dhe nacionalizmit ekstrem.

Por pikërisht këtu lind pyetja thelbësore, a po përdoret sot kjo kujtesë si udhërrëfyes moral, apo si instrument politik?



Kur kujtesa ndahet nga morali

Kujtesa historike, e shkëputur nga koherenca morale, shndërrohet në hipokrizi politike. Ajo humbet funksionin e saj etik dhe bëhet ritual bosh, ceremonial formal dhe deklarativ, pa asnjë ndikim real në vendimmarrje.

Europa e ka jetuar për dekada peshën e fajit historik. Disa vende vazhdojnë edhe sot të mbajnë mbi vete barrën morale dhe politike të bashkëpunimit, heshtjes ose paafetësisë për të ndaluar krimin nazist. Kjo është arsyeja pse përkujtimi i Holokaustit është i domosdoshëm.

Por përkujtimi nuk mjafton nëse nuk shoqërohet me **qëndrime të qarta morale ndaj krimeve të sotme**.

Shqiptarët dhe zgjedhja morale në Luftën e Dytë Botërore

Në panoramën tragjike të Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët zgjodhën një rrugë tjetër. Në një Europë ku hebrenjtë dorëzoheshin, denoncoheshin dhe deportoheshin drejt kampeve të shfarosjes, shqiptarët refuzuan t'i dorëzonin.



Jo vetëm kaq, ata i strehuan, i ushqyen, i fshehën dhe i mbrojtën, shpesh duke rrezikuar jetën e tyre dhe të familjeve të tyre. Shqipëria doli nga lufta me më shumë hebrenj sesa kishte në fillim.

Kjo histori nuk flet aq për hebrenjtë e shpëtuar, sa flet për shqiptarët që zgjodhën nderin mbi frikën, moralin mbi urdhrin dhe jetën mbi ideologjinë. Është një shembull i rrallë ku një shoqëri e vogël, e varfër dhe e pushtuar, tregoi një madhështi morale që mungoi në shumë vende të zhvilluara të Europës.

Ceremoni pa përlësi morale

Pikërisht për këtë arsye, simbolika e vizitave, ceremonive dhe fjalimeve solemne sot shpesh tingëllon e zbrazët dhe hipokrite. Sepse më shumë sesa spektakël përkujtimor, Holokausti kërkon përlësi morale.

Kërkon falënderim për ata që shpëtuan jetë. Kërkon reflektim të sinqertë për ata që heshtën. Dhe mbi të gjitha, kërkon **konsistencë etike** në përballjen me krimet e sotme.

Kur kujtesa përdoret për të shpëlarë imazhe politike, për të justifikuar aleanca ose për të mbuluar krime aktuale, ajo pushon së qeni kujtesë dhe kthehet në propagandë.

Gaza: Krime të reja nën hijen e një tragjedie të vjetër

Sot, bota përballet me një realitet tronditës në Gaza. Ajo që po ndodh atje nuk është thjesht konflikt i armatosur. Është një krizë humanitare e përmasave katastrofike.

Bombardime të vazhdueshme, shkatërrim sistematik i infrastrukturës civile, spitaleve, shkollave dhe strehimeve. Përdorimi i urisë si mjet lufte. Ndëshkimi kolektiv i një popullsie të tërë. Zhvendosje masive të detyruara. Vrasje të mijëra civilëve, përfshirë gra dhe fëmijë.

Dhe ndërkohë, Holokausti i djeshëm përdoret si **alibi morale** për të mbyllur sytë ndaj këtyre krimeve.

“Kurrë më”, për kë?

Retorika “kurrë më” përsëritet çdo vit në ceremonitë

për Holokaustin. Por sot ajo duket gjithnjë e më selektive.

“Kurrë më” për hebrenjtë me të drejtë. Por pse jo “kurrë më” edhe për palestinezët e pambrojtur? Pse uria, bombardimet dhe shkatërrimi masiv justifikohen si “domosdoshmëri sigurie”?

Këtu qëndron paradoksi moral i kohës sonë: një botë që përkujton krimet e djeshme, por relativizon krimet e sotme.

Faktet që politika përpigjet t'i anashkalojë

Raportet e Kombeve të Bashkuara, deklaratat e agjencive humanitare dhe vlerësimet e organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kanë ngritur alarme të vazhdueshme për shenja të një politike me tipare gjenocidiale në Gaza.

Përdorimi i urisë si armë lufte, ndëshkimi kolektiv, zhvendosjet e detyruara dhe vrasjet masive të civilëve janë shkelje flagrante të Konventave të Gjenevës dhe të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Këto nuk janë opinione. Janë fakte të dokumentuara.

Mësimi që nuk u mësu

Historia na ka treguar se njerëzimi shpesh dështon të nxjerrë mësim nga e kaluara. Holokausti duhej të ishte kufiri i fundit moral. Por sot, ai rrezikon të kthehet në precedent të instrumentalizuar.

Nëse Holokausti përdoret për të justifikuar heshtjen ndaj krimeve të reja, atëherë ai tradhëtohet dy here, një herë nga xhelatët e djeshëm dhe një herë nga hipokritët e sotëm.

Kujtesa si përgjegjësi, jo si justifikim

Përkujtimi i Holokaustit është detyrim moral. Por ai nuk ka kuptim nëse nuk shndërrohet në mbrojtje aktive të jetës njerëzore sot.

Drejtësia nuk mund të jetë selektive. Humanizmi nuk mund të ketë kombësi. Dhe kujtesa nuk mund të përdoret për të heshtur ndërgjegjen.

Nëse “kurrë më” nuk vlen për të gjithë, atëherë nuk vlen për askënd.

ISMAIL KADARE - 90 VJET NGA LINDJA

Shkrimtari që i dha gjuhës shqipe dimension shtetëror dhe identitetit kombëtar peshë europiane

Më 28 janar do të shënohej 90-vjetori i lindjes së Ismail Kadaresë, figurës më përfaqësuese të letërsisë shqipe dhe një prej emrave më të rëndësishëm të kulturës europiane të shekullit XX. Kadare nuk ishte vetëm shkrimtar i madh; ai ishte një institucion kulturor në vetvete, një faktor i rëndësishëm i përfaqësimit të Shqipërisë në botë dhe një zë që e ngriti gjuhën shqipe në nivelin e gjuhëve me traditë të konsoliduar letrare.

Në historinë e kombeve, janë të paktë autorët që arrijnë të ndikojnë jo vetëm në letërsi, por edhe në vetëdijen shtetërore dhe kombëtare. Ismail Kadare ishte një prej tyre.

Kadare dhe përfaqësimi ndërkombëtar i Shqipërisë

Lajmi i ndarjes së tij nga jeta u pasqyrua nga mediat më prestigjioze ndërkombëtare si humbja e një shkrimtari të madh europian. Presidenti i Republikës Franceze, Emmanuel Macron, e vlerësoi publikisht si një ndër figurat qendrore të kulturës kontinentale. Ky reagim nuk ishte formal; ai pasqyronte statusin real që Kadare kishte fituar ndër dekada në botën akademike dhe letrare perëndimore.

I përkthyer në **48 gjuhë**, fitues i çmimeve më të rëndësishme ndërkombëtare dhe anëtar i institucioneve elitare kulturore, Kadare u bë një nga përfaqësuesit më seriozë të identitetit shqiptar jashtë kufijve shtetërorë. Në një kohë kur Shqipëria njihej shpesh për izolimin, konfliktet apo tranzicionin e vështirë, vepra e tij ishte dëshmi se ky vend prodhonte kulturë të nivelit më të lartë.




Letërsia si forcë strategjike e kombit

Në optikën shtetërore dhe institucionale, kultura nuk është element periferik. Ajo është pjesë e asaj që sot quhet **fuqi e butë (soft power)**. Ismail Kadare ishte, për dekada, komponenti më i qëndrueshëm i kësaj fuqie për Shqipërinë. Romanet dhe esetë e tij nuk ishin thjesht krijime artistike, por analiza të thella të pushtetit, autoritetit, ligjit, frikës, besnikërisë dhe qëndresës – tema thelbësore edhe për formimin e ndërgjegjes qytetare dhe shtetërore. Në këtë kuptim, vepra e Kadaresë ka vlerë jo vetëm kulturore, por edhe edukative dhe formuese për brezat, përfshirë ata që shërbejnë në institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes.

Shqipëria përballë detyrimit të kujtesës

Me gjithë këtë kontribut të jashtëzakonshëm, nderimi institucional në Shqipëri ka mbetur i kufizuar.



Emërtimi i rrugëve, shkollave dhe institucioneve publike shpesh është bërë pa kriter të qartë kombëtar, duke e relativizuar vetë konceptin e nderimit. Deri më sot, mungon një hapësirë publike kombëtare që ta përfaqësojë qartë figurën dhe veprën e Ismail Kadaresë në përmasa të denja.

Ky nuk është thjesht problem simbolik. Kujtesa institucionale është pjesë e sigurisë kulturore të një kombi. Një shtet që nuk ndërton referenca të qarta për figurat e tij themelore, rrezikon të dobësojë vazhdimësinë e vet identitare.

Shembulli francez dhe mësimi institucional

Franca e kuptoi herët rëndësinë e Kadaresë. Ai u pranua si anëtar i Akademisë Morale dhe Politike, u përfshi në programet shkollore dhe u trajtua si autor klasik i gjallë. Vendosja e një pllake përkujtimore në Paris nuk ishte akt sentimental, por institucional.

Ky model tregon se nderimi i figurave të mëdha nuk është çështje emocioni, por strategji kulturore dhe shtetërore. Për një vend si Shqipëria, me sfida të vazhdueshme në konsolidimin e imazhit ndërkombëtar, ky mësim mbetet aktual.

Kadare dhe identiteti europian i shqiptarëve

Ismail Kadare ishte një nga mbrojtësit më konsekuentë të përkatësisë europiane të Shqipërisë. Jo përmes

deklaratave politike, por përmes veprës. Në letërsinë e tij, Shqipëria shfaqet si pjesë e historisë së madhe kontinentale, me tragjedi, dilema dhe përgjegjësi të përbashkëta.

Kjo qasje ka rëndësi të veçantë për institucionet shtetërore, përfshirë Forcat e Armatosura, të cilat operojnë sot në një kontekst euroatlantik dhe ndërkombëtar. Kadare kontribuoi në ndërtimin e një narrative kombëtare dinjitoze, pa të cilën integrimi mbetet formal.

Përtej përmendores

Ismail Kadare nuk ka nevojë për monument për të ekzistuar në kujtesën kombëtare. Vepra e tij është monumenti më i qëndrueshëm. Megjithatë, shteti ka detyrimin moral dhe institucional ta bëjë këtë vepër të dukshme në hapësirën publike, si pikë reference për brezat e ardhshëm.

Mirënjohja institucionale mund të vonojë, por vlera e veprës së tij vetëm sa rritet me kohën. Ajo mbetet pasuri kombëtare, pjesë e sigurisë shpirtërore dhe kulturore të Shqipërisë.

Në 90-vjetorin e lindjes së Ismail Kadaresë, reflektimi është i domosdoshëm: kombet maten edhe nga mënyra se si ruajnë dhe nderojnë figurat e tyre themelore. Kadare i dha Shqipërisë një zë të respektuar në botë. Detyra e institucioneve është ta ruajnë këtë trashëgimi me dinjitet, qartësi dhe përgjegjësi historike.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Populli shqiptar, në çdo etapë të historisë së tij, u ka ngritur monumente bijve që kanë rënë për Atdheun. Edhe pse shpesh i varfër, ai ka kursyer dhe ka mbledhur aq para sa ka mundur për të ngritur një monument, një statujë apo një përmendore. Dhe kur këto kanë munguar, mbi varret e tyre ka vendosur pllaka guri dhe ka kënduar këngë kujtese.

Përveç vëllimeve “Yje të pashuar”, kushtuar dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare, janë botuar edhe vëllimet monumentale për dëshmorët e rënë pas Çlirimit, të njohura me titullin domethënës “Heronj të heshtur”.

Historia mijëravjeçare e popullit shqiptar ka qenë e mbushur me përballje të vazhdueshme me armiq të shumtë. Në shekuj, në luftëra e në paqe, janë shfaqur dhe janë përzier elementë armiqësorë të ndryshëm, në gjuhë, zakone, fe e forma veprimi, me një synim të vetëm: zhdukjen e kombit dhe të shtetit shqiptar. Prania e elementit armik ka qenë dhe mbetet një realitet i pandërprerë, ndërsa harresa e tij sjell pasoja të rënda për kohë të gjatë.

Në këtë truall, të bekuar nga Zoti, janë thyer armata, janë mposhtur doktrina dhe është arritur qëndresa. Që nga koha e Skënderbeut e deri në ditët e mëvonshme, historia njeh veprimtarinë e informatorëve dhe agjentëve, të cilët, të maskuar si të varfër e lypsarë, përpiqeshin të zbulonin kështjella, armatime, rrugë furnizimi, për të sabotuar dhe për të thyer besimin e popullit.

Këto forma armiqësore vazhduan në shekuj: me helmime, me zhdukje figurash të arsimit e kulturës, me djegie e masakra, vetëm e vetëm që populli shqiptar të mos ecte në rrugën e përparimit shoqëror.

Vepra “Heronj të heshtur” është një basoreliev i madh historik, që pasqyron të vërtetën e jetës dhe të sakrificës së këtyre dëshmorëve, të cilët populli me të drejtë i quajti të heshtur. Në këto libra pasqyrohet një pjesë e jetës së tyre, mënyra se si, në kushte jashtëzakonisht të vështira, ata luftuan dhe mbrojtën sakrificat e lirisë së fituar. Ata ranë si ushtarë të Atdheut, të rreshtuar për të mbrojtur paqen dhe rendin e pasluftës.

Shqipëria e viteve të para pas Çlirimit ishte në ndërtim. Në gjithë vendin kishin nisur aksionet për ndërtimin e rrugëve dhe urave, reforma agrare, votimet, fushatat kundër analfabetizmit, këngët e reja dhe shpresa për një jetë më të mirë.

Ndërkohë, veprimet luftarake kishin pushuar, por heronjtë e heshtur vazhdonin të ishin partizanë me pushkë në krah, me bomba në brez dhe me vigjilencë të lartë. Ata ndiqnin mbeturinat e bandave armiqësore, diversantët dhe kriminelët që pengonin ndërtimin e jetës së re dhe pushtetit të popullit. Në acar e vapë, në dimër e në stuhi, ata qëndronin në shërbim të Atdheut, të heshtur, por të vendosur.

Armiku që ndiqnin ishte po aq i egër sa pushtuesit fashistë, i njollosur nga krime kundër popullit, kundër të rinjve, mësuesve, grave e vajzave që kërkonin jetën e re. Në përballje me këtë reaksion, këta partizanë të paqes pritën plumbat në ballë, në gjoks, në prita buzë rrugëve, në pyje, pranë shtëpive dhe shkollave.

Në këtë luftë, ashtu si gjatë LANÇ-it, ata kishin

HERONJ TË HESHTUR...



Zaide Vata

përkrahjen e pandërprerë të popullit. Ata ranë në llogoren e mbrojtjes së paqes dhe të lirisë së fituar.

Në vitin 1946 u krijua një varrezë e madhe e dëshmorëve të heshtur, një kambanë kujtese dhe kushtimi, një mësim historie se paqja dhe liria mbrohen me gjakun e bijve të popullit. Ata na lanë një porosi të qartë: kujtim, nderim dhe mësim – Atdheu mbi të gjitha.

Heronjtë e heshtur janë të shpërndarë në çdo cep të Shqipërisë. Jeta dhe vepra e tyre përbëjnë një kronikë epike, të ashpër dhe heroike nga fillimi në fund. Njohja e tyre është një detyrim moral për shoqërinë dhe për shtetin shqiptar. Monumentet, edhe kur janë të venitura nga koha, vazhdojnë të flasin për një histori që nuk shuhet kurrë.

Në librat për heronjtë e heshtur është skalitur me thjeshtësi dhe lavdi vepra e tyre e pavdekshme. Po përmendim vetëm dy shembuj nga qindra dëshmorë:

Nëna Zaide Vata

Zaide Sinan Vata lindi në vitin 1905, në fshatin Surroj të Kukësit. Në vitin 1946 ajo ishte nënë e dy fëmijëve jetimë, Nailes dhe Ramës. Me mundime të mëdha i kishte rritur, pasi bashkëshorti i kishte ndërruar jetë. Një natë, diversantë u paraqitën në shtëpinë e saj duke kërkuar bukë dhe strehë. Nëna i kuptoi menjëherë. Forcat e ndjekjes kishin rrethuar shtëpinë dhe, në mes të oborrit, njëri nga kriminelët e qëllloi. Ajo ra dëshmore e heshtur, u shpall Dëshmore e Atdheut dhe u dekorua me Medaljen e Trimërisë.

Martina Nikollë Kalthi

Martina Kalthi lindi në vitin 1926 në Bushkash të Matit. Grua e thjeshtë, punëtore dhe trimëreshë, ajo u përball me kriminelët në shtëpinë e saj më 1946. Pa u trembur nga rreziku, ajo u përlesh trup më trup me një bandit, ia rrëmbeu armën dhe e shtriu përtokë, por u qëllua pas shpine nga një tjetër. Ajo ra si heroinë, duke u bërë simbol i trimërisë së grave shqiptare.

Në vitin 1946 ranë në fushën e nderit dhjetëra bij e bija të popullit shqiptar, mes tyre: Adem Mustafa Vrapit, Ethem Bajram Mustafaj, Ethem Sulçe Plaka, Fadil Refik Mezini, Haziz Beqir Dobra, Hazis All Hoxha,



Martina Kalthi

Hamdi Beqir Çela, Hasan Qamil Agolli, Hasan Murat Korbi, Hasan Myftar Kërzhalliu, Hajredin Sali Prifti, Hito Iljaz Majkaj, Hysni Hekuran Zotka, Hysni Shaban Mullolli, Hysni Hakik Gërbolli, Ibrahim Hasan Duka, Ibrahim Shemshi Daci, Idai Arshin Demaj, Jonuz Qazim Toska, Kadri Ibrahim Greca, Kasëm Destan Tanushi, Kin Mark Kulli, Kristaq Petro Caci, Kolë Nikollë Hubaj, Kolë Bibë Luka, Koci Pandi Jorgji, Likë Bush Doku, Liman Idriz Laçi, Martina Nikollë Kalthi, Maxhun Fetah Mehmetaj, Matosh Ukë Përkola, Maliq Ismail Pasho, Mexhan Dule Arapi, Miço Spiro Boga, Mustafa Bajram Lulja, Mustafa Dibra, Mynyr Shaban Shpata, Nazif Qerim Ibraj, Namik Ismail Osmani, Ndrec Ndue Gjoka, Ndoc Shtjefën Kini, Ndoc Bib Kaçori, Nebi Alem Llanaj, Nebi Dule Mehmeti, Nimet Sabit Muçaj, Nuri Mehmet Pashollari, Nuhi Bistim Voka, Pal Zef Lleshi, Prengë Pal Carra, Prengë Llesh Losi, Prengë Mark Pali, Petro Llasi Dhespotllari, Qermi Ram Kurti, Rahman Xhemal Dollani, Ramadan Haxhi Qorri, Rahman Rusten Xhaferllar, Ramiz Hamza Marjani, Rakip Arif Disha, Rakip Tahir Bejkollari, Ram Sabri Meshi, Rrap Sulejman Habili, Remzi Nazis Koro, Rexhë Deli Rexha, Refki Sali Menkolli, Rexhep Rahman Bajrami, Refat Mustafa Teta, Riza Man Leka, Rushit Vesel Zyferi, Rustem Fastli Qelia, Sali Haziz Kryeziu, Sabri Baftjar Jaupllari, Sadik Rrapush Koçi, Safet Abaz Jahjai, Selim Arif Musai, Selim Ali Ceka, Selim Sulejman Sulillari, Seit Seit Pepa, Stefan Risto Bino, Shaban Ali Çarçiu, Shaban Bajram Nure, Shafit Shaban Zenaj, Shyqyri Reshat Meka, Turabi Ethem Izbo, Thanas Liçi Shkurti, Vangjel Thoma Koleci, Vath Ahmet Stafa, Veledin Bajrami, Veledin Nureddin Serjani, Veli Reshit Sukja, Veli Hysen Xhymerti, Veli Arif Tosku, Vesel Myftar Çako, Xhemal Rakip Nezha, Xhemal Muharram Torovelli, Xhemal Ramadan Hysa, Xhevit Abaz Pjeçi, Xheladin Avdi Marati, Zaide Sinan Vata, Zeqo Musa Gërxana, Zenel Arshin Islami, Zef Simon Gega, Zet Mark Ndou, etj.

Të gjithë duhen nderuar dhe përkujtuar, qoftë dhe thjeshtë me një kurorë në varrin e tyre nga Organizata e Dëshmorëve dhe familjarët e tyre.

Emër me vlera për qytetarinë, rendin dhe krenarinë kombëtare

Milto Kordha – figurë dinjitoze e Policisë së Shtetit



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Një jetë në shërbim të rendit, ligjit dhe sigurisë publike

Historia e Policisë së Shtetit shqiptar është ndërtuar mbi kontributin e shumë burrave dhe grave që i shërbyen shtetit në periudha të vështira, shpeshherë në kushte të jashtëzakonshme shoqërore dhe politike. Ndër këto figura që spikasin për vazhdimësi, përkushtim dhe profesionalizëm, renditet edhe Milto Petro Kordha, oficer karriere, drejtues policor dhe një nga emrat që i dha dinjtet uniformës së policisë shqiptare.

Milto Petro Kordha lindi më 10 gusht 1953, në fshatin Bestrovë të rrethit të Vlorës. Jeta e tij u përball herët me vështirësi, pasi mbeti pa nënë vetëm gjashtë muajsh. Rritja dhe formimi i tij u morën përsipër nga familja dhe veçanërisht nga gjyshja Angjelina, e cila luajti rol të rëndësishëm në edukimin moral dhe njerëzor të tij. Kjo periudhë ndikoi ndjeshëm në ndërtimin e karakterit të një njeriu të fortë, të përgjegjshëm dhe të lidhur ngushtë me vlerat familjare dhe shoqërore.

Formimi arsimor dhe hyrja në radhët e policisë

Arsimin fillor dhe tetëvjeçar e përfundoi në vendlindje, ndërsa arsimin e mesëm në gjimnazin “Halim Xhelo” të Vlorës, të cilin e mbaroi në vitin 1972 me rezultate shumë të mira. Rezultatet e larta mësimore, korrektësia dhe sjellja shembullore e bënë pjesë të brezit të rinjve që u përzgjedhën për të ndjekur studimet në Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në atë periudhë, arsimi policor shqiptar po hynte në një fazë të re zhvillimi, pasi me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 20.12.1971, Shkolla e MPB-së kishte marrë statusin e arsimit të lartë. Milto Kordha ishte pjesë e këtij brezi të parë oficerësh të formuar sipas një vizioni më modern policor. Studimet i përfundoi me sukses dhe në vitin 1974 u titullua oficer policie, duke nisur menjëherë shërbimin aktiv.

Hapat e parë në detyrë dhe konsolidimi profesional

Detyra e parë e Milto Kordhës ishte ajo e komandantit të repartit të shërbimeve në Gramsh, ku shërbeu nga viti 1974 deri në vitin 1980. Ishte një periudhë formuese, ku ai u përball me realitete të ndryshme territoriale dhe sociale, duke fituar përvojë të drejtpërdrejtë në drejtimin e trupave dhe në zbatimin e ligjit.

Në Gramsh ai u dallua për seriozitet, disiplinë, korrektësi në zbatimin e detyrës dhe aftësi për të ndërtuar marrëdhënie të shëndosha me komunitetin. Kolegët dhe vartësit e kujtojnë si drejtues kërkues, por gjithnjë i drejtë dhe i balancuar, tipare që do ta shoqëronin gjatë gjithë karrierës.

Pas një kursi të specializuar në Shkollën e Lartë të MPB-së në Sauk, ai vijoi shërbimin në sektorë të ndryshëm operativë, fillimisht në Gramsh dhe më pas në Fier, ku mori përgjegjësi



gjithnjë e më të larta.

Detyra drejtuese dhe shërbimi në disa qarqe të vendit

Nga mesi i viteve '80 e në vijim, Milto Kordha shërbeu në detyra drejtuese në Fier, Vlorë dhe Durrës, duke ushtruar funksione si përgjegjës sektori, zëvendëskryetar dhe shef policie. Me ndryshimet politike të fillim viteve '90, ai u përball me sfida të reja institucionale dhe shoqërore, por ruajti një profil profesional të qëndrueshëm.

Me rivendosjen e gradave në vitin 1991, u gradua Nënkolonel dhe më pas Kolonel, çka dëshmon për vlerësimin institucional të karrierës së tij. Në këtë periudhë, ai mbajti edhe detyrën e Drejtorit të Policisë së Vlorës, një nga strukturat më të ndjeshme të rendit publik në vend.

Përballja me tranzicionin dhe vitin 1997

Ngjarjet e vitit 1997 shënojnë një nga periudhat më dramatike të shtetit shqiptar. Shpërbërja e strukturave, armatosja masive e popullsisë dhe rënia e autoritetit shtetëror e vendosën Policinë e Shtetit përballë një sfide ekzistenciale.

Në këtë kontekst, figura e Milto Kordhës spikat si drejtues që, pavarësisht vështirësive, u angazhua maksimalisht për ruajtjen e rendit dhe mbrojtjen e jetës së qytetarëve. Në Vlorë dhe më pas në Fier, ai u përpoq të menaxhonte situata me tension të lartë, duke vepruar me maturi, profesionalizëm dhe përgjegjësi.

Milto Petro Kordha lindi më 10 gusht 1953, në fshatin Bestrovë të rrethit të Vlorës. Jeta e tij u përball herët me vështirësi, pasi mbeti pa nënë vetëm gjashtë muajsh. Rritja dhe formimi i tij u morën përsipër nga familja dhe veçanërisht nga gjyshja Angjelina, e cila luajti rol të rëndësishëm në edukimin moral dhe njerëzor të tij. Kjo periudhë ndikoi ndjeshëm në ndërtimin e karakterit të një njeriu të fortë, të përgjegjshëm dhe të lidhur ngushtë me vlerat familjare dhe shoqërore.

Pas kësaj periudhe, ai u rikthye në detyra të rëndësishme drejtuese në Fier, Shkodër, Elbasan, Berat dhe Durrës, kryesisht në strukturat e Policisë Kriminale dhe komisariateve kryesore.

Vitet e fundit të shërbimit dhe largimi nga policia

Në vitet 2000–2006, Milto Petro Kordha shërbeu në disa funksione të rëndësishme, përfshirë drejtimin e policisë në qarkun Shkodër dhe drejtimin e komisariateve të mëdha urbane. Detyra e fundit funksionale ishte ajo e shefit të sektorit për luftën kundër krimit të hapur në Drejtorinë e Policisë së Qarkut të Vlorës.

Në vitin 2006, pas 32 vitesh shërbimi aktiv, ai përfundoi marrëdhëniet e punës me Policinë e Shtetit. Edhe pse u largua në moshë ende produktive, ai mbeti i lidhur shpirtërisht me institucionin dhe me misionin e tij.

Trashëgimia dhe kujtesa institucionale

Milto Petro Kordha u nda nga jeta, më 30 janar 2011, në moshën 58-vjeçare. Ai la pas bashkëshorten Eminenë, djalin Eduartin dhe vajzën Sonila, si dhe respektin e thellë të kolegëve dhe komuniteteve ku shërbeu. Figura e tij përfaqëson modelin e oficerit të karrierës që i shërbeu shtetit pa kompromis, pa kërkuar privilegje dhe pa punuar për lavdi personale. Ai mbetet pjesë e memories institucionale të Policisë së Shtetit dhe një shembull frymëzues për brezat e rinj të forcave të rendit.

Misteri i Stonehenge zbulohet:

Shkencëtarët gjejnë gjurmë që tregojnë se gurët gjigantë janë transportuar nga njerëzit

Një monument që sfidon kohën

Stonehenge është një nga monumentet më të famshme dhe më enigmatike të botës. I ndërtuar mijëra vite më parë në fushat e Wiltshire, Angli, ky kompleks me gurë gjigantë ka ngjallur gjithmonë kureshtje dhe debate të pafundme. Kush e ndërtoi? Si u transportuan gurët masivë? Çfarë funksioni kishte ky vend? Për dekada me radhë, këto pyetje kanë mbetur pa përgjigje të qarta.

Teoria e re: Gurët e lëvizur nga njerëzit



Shkencëtarët studiovan kokrrizat e mineraleve zirkon (në foto) dhe apatit, të cilat veprojnë si orë gjeologjike duke bllokuar uraniumin radioaktiv. Nëse transporti akullnajor është i saktë, moshë e këtyre kokrrizave duhet të përputhet me moshën e shkëmbinjve në Uells.

Së fundmi, një grup shkencëtarësh ka sjellë prova të reja që hedhin dritë mbi misterin. Studimet e fundit sugjerojnë se gurët e mëdhenj të Stonehenge nuk janë thjesht produkte të natyrës së vendosur rastësisht, por janë transportuar me kujdes nga njerëzit e epokës neolitike. Analizat e kokrrave të rërës të gjetura pranë monumentit kanë treguar gjurmë të qarta të ndërhyrjes njerëzore, duke dëshmuar se ky proces ka qenë i planifikuar dhe i realizuar me mjete primitive, por efektive.

Sfida e transportit të gurëve gjigantë

Gurët e Stonehenge, disa prej të cilëve peshojnë mbi 25 ton, përbëjnë një sfidë të jashtëzakonshme logjistike. Shkencëtarët besojnë se komunitetet e lashta përdorën kombinime të teknikave të thjeshta, si rula prej druri, litarë të trashë dhe platforma të improvizuara, për të zhvendosur këta gurë nga distanca të largëta. Ky proces kërkonte bashkëpunim të madh, organizim social dhe një vizion të qartë për ndërtimin e një strukture që do të kishte rëndësi të veçantë për komunitetin.

Funksioni i Stonehenge

Edhe pse transporti i gurëve është një mister i zgjidhur pjesërisht, pyetja tjetër e madhe mbetet: përse



u ndërtua Stonehenge? Shumë studiues mendojnë se ky monument ka pasur funksione astronomike, duke shërbyer si një kalendar gjigant për të përcaktuar solsticet dhe ekuinokset. Të tjerë e shohin si një vend ritualesh fetare, ku njerëzit e lashtë kryenin ceremoni për të nderuar hyjnitë e tyre. Ka edhe teori që e lidhin Stonehenge me shërimin dhe energjitë mistike, duke e konsideruar si një qendër shpirtërore të kohës.

Provat e reja dhe rëndësia e tyre

Zbulimi i gjurmëve të rërës që tregojnë transportin e gurëve nga njerëzit është një hap i madh përpara në kuptimin e historisë së Stonehenge. Kjo provë jo vetëm që vërteton aftësitë teknike të komuniteteve të lashta, por edhe tregon nivelin e tyre të organizimit dhe bashkëpunimit. Përmes këtij zbulimi, ne kuptojmë më mirë se sa të aftë kanë qenë njerëzit e epokës neolitike për të realizuar projekte monumentale.

Një trashëgimi që frymëzon

Stonehenge mbetet një simbol i fuqisë së njeriut për të sfiduar natyrën dhe kohën. Ky monument nuk është thjesht një grup gurësh të vendosur në një fushë, por një dëshmi e gjallë e kreativitetit, besimit dhe vendosmërisë së njerëzimit. Çdo zbulim i ri na afron më shumë me të vërtetën, por gjithashtu na kujton se misteret e historisë nuk zgjidhen kurrë plotësisht. Stonehenge do të vazhdojë të mbetet një burim frymëzimi dhe kureshtjeje për brezat e ardhshëm.

Zbulimet e fundit mbi transportin e gurëve të Stonehenge nga njerëzit janë një dëshmi e fuqishme e aftësive të komuniteteve të lashta. Ky monument, imbuluar nga misteri për shekuj, po na tregon ngadalë sekretet e tij.

Megjithatë, pyetjet mbi funksionin e tij të vërtetë mbeten ende të hapura. A ishte një observator astronomik, një vend ritualesh, apo një qendër shpirtërore? Përgjigjet mund të mos jenë kurrë të plota, por rruga drejt zbulimit është po aq e rëndësishme sa vetë misterit.

Perspektiva të reja dhe zbulime të tjera

Përveç zbulimeve mbi transportin e gurëve, studiuesit kanë filluar të eksplorojnë edhe aspekte të tjera të Stonehenge që mund të ofrojnë më shumë kuptim për funksionin dhe rëndësinë e tij. Disa prej këtyre përfshijnë:

Studimet gjeofizike dhe gjeologjike: Teknologjitë moderne si radarët me penetrim në tokë kanë zbuluar struktura të fshehura nën tokë pranë Stonehenge, duke sugjeruar se kompleksi mund të jetë pjesë e një rrjeti më të madh ceremonish dhe vendbanimesh.

Analizat e mbetjeve organike: Gjetjet e mbetjeve të kafshëve dhe bimëve pranë monumentit tregojnë se aty janë kryer ceremoni të ndryshme, përfshirë edhe festa dhe rituale të lidhura me ciklet natyrore.

Studimet astronomike të avancuara: Përveç funksionit të kalendarit, disa studiues sugjerojnë se Stonehenge mund të ketë shërbyer si një observator për ndjekjen e fenomeneve të rralla astronomike, si kalimi i kometave ose eklipset.

Roli social dhe politik: Stonehenge mund të ketë qenë një vend ku komunitetet e ndryshme bashkoheshin për të forcuar lidhjet sociale dhe për të treguar fuqinë dhe statusin e tyre. Këto perspektiva të reja theksojnë se Stonehenge nuk është vetëm një strukturë fizike, por një qendër komplekse me shumë dimensionë, që ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore, fetare dhe kulturore të njerëzve të lashtë.


Sistemet nënujore: Revolucioni i heshtur i teknologjisë ushtarake

Një betejë e padukshme në sipërfaqe

Në shekullin XXI, oqeanet nuk janë më thjesht rrugë tregtare apo burime natyrore. Ato janë kthyer në një fushë të re beteje, ku fuqitë e mëdha po garojnë për dominim. Në këtë garë, teknologjia nënujore është bërë një element kyç. Ndryshe nga avionët luftarakë apo raketat hipersonike që shihen dhe dëgjohen, sistemet nënujore veprojnë në heshtje, larg syve të publikut, por ndikimi i tyre është i jashtëzakonshëm. Ky është revolucioni i heshtur i teknologjisë ushtarake, një transformim që po ndryshon mënyrën se si konceptohet siguria globale.

Çfarë përfshijnë sistemet nënujore?

Sistemet nënujore janë një kombinim kompleks pajisjesh dhe rrjetesh. Në bazë të tyre qëndrojnë sensorët e shpërndarë, pajisje të vogla që vendosen në fundin e detit për të monitoruar lëvizjet e anijeve dhe nëndetësve. Këta sensorë janë të lidhur me rrjete të integruara, të cilët komunikojnë me satelitë dhe qendra komanduese, duke krijuar një pamje të plotë të aktivitetit nënujor. Një tjetër element janë dronët nënujorë, mjete pa pilot që patrollojnë, mbledhin të dhëna dhe kryejnë operacione të fshehta. Përveç tyre, ekzistojnë platforma hibride, që mund të operojnë si robotë nënujorë, por edhe të ngrihen në sipërfaqe për komunikim dhe mbledhje të dhënash.



Pse janë kaq të rëndësishme?


Rëndësia e sistemeve nënujore është e shumëfishtë. Së pari, ato ofrojnë mbrojtje për infrastrukturën kritike. Kabllot nënujore të internetit, tubacionet e gazit dhe energjisë, si dhe strukturat e tjera të fshehura në det, janë bërë objektiva të cënueshëm. Një rrjet sensorësh mund të garantojë monitorim të vazhdueshëm dhe të parandalojë ndërhyrjet e padëshiruara. Së dyti, ato ofrojnë dominim strategjik. Kush kontrollon oqeanet, kontrollon tregtinë globale, por kush kontrollon nënujin, kontrollon informacionin dhe sigurinë. Ky është një avantazh i pakrahasueshëm që fuqitë e mëdha nuk duan ta humbasin. Së treti, sistemet nënujore ofrojnë zbulim të hershëm. Sensorët mund të identifikojnë lëvizjet e nëndetësve armike shumë më herët sesa radarët tradicionalë, duke i dhënë një avantazh të madh në mbrojtje.

Zhvillimet më të fundit

Në vitet e fundit, fuqitë e mëdha kanë intensifikuar investimet në këtë fushë. Shtetet e Bashkuara dhe NATO kanë nisur projekte për rrjete nënujore të shpërndara në Atlantik dhe Paqësor, me synim monitorimin e aktivitetit rus dhe kinez. Kina po investon në atë që e quan "Muri i Madh Blu", një sistem gjigant sensorësh që mbulon Detin e Kinës Jugore. Rusia ka prezantuar dronë nënujorë të aftë për të transportuar ngarkesa të rënda dhe për të operuar në thellësi ekstreme. Madje edhe teknologjitë civile, si robotët për eksplorim të oqeanit, po përshtaten për përdorim ushtarak, duke ulur kostot dhe duke rritur efikasitetin.

Sfida dhe reziqe

Ky revolucion nuk vjen pa sfida. Ndërtimi i një rrjeti nënujor kërkon investime kolosale, që mund të rëndojnë buxhetet kombëtare. Sistemet e lidhura me rrjete janë të cënueshme ndaj sulmeve kibernetike, duke krijuar pika të reja dobësie. Përdorimi i dronëve autonomë ngre pyetje etike mbi kontrollin njerëzor dhe përgjegjësinë në



rast incidentesh. Për më tepër, pajisjet nënujore mund të ndikojnë ekosistemet detare, duke ndryshuar sjelljen e gjallesave dhe duke krijuar pasoja të paparashikuara për mjedisin.

Një garë e re globale

Në të kaluarën, garat ushtarake janë përqendruar në tokë dhe në qiell. Sot, gara e re është nën ujë. Fuqitë e mëdha e shohin këtë si një "front të heshtur", ku nuk ka beteja të dukshme, por ka një luftë të vazhdueshme për informacion, kontroll dhe dominim. Në këtë garë, teknologjia nuk është më thjesht një mjet, por një armë strategjike që mund të përcaktojë fatin e konflikteve globale.

Perspektiva e së ardhmes

E ardhmja e sistemeve nënujore pritet të jetë edhe më e sofistikuar. Integrimi i inteligjencës artificiale do të lejojë që dronët dhe sensorët të marrin vendime në kohë reale pa ndërhyrje njerëzore. Energjia e rinovueshme nënujore, si turbinat e vogla që shfrytëzojnë rrymat e detit, mund të furnizojë këto sisteme pa nevojë për bateri tradicionale. Po ashtu, pritet që rrjetet nënujore të lidhen drejtpërdrejt me sistemet hapësinore, duke krijuar një arkitekturë të plotë të mbrojtjes globale.

Sistemet nënujore nuk janë më fantashkencë; ato janë realitet dhe po formësojnë mënyrën se si do të duket lufta e së ardhmes. Në një botë ku informacioni është po aq i rëndësishëm sa armët, kontrolli i oqeanëve nën sipërfaqe mund të vendosë fatin e konflikteve globale. Ky është revolucioni i heshtur i teknologjisë ushtarake – një betejë që zhvillohet larg syve tanë, por që mund të përcaktojë ekuilibrin e fuqive në shekullin XXI.

Shembuj historikë: Nga Lufta e Ftohtë tek epoka digjitale

Përdorimi i sistemeve nënujore nuk është një risi e plotë e kohëve të fundit. Gjatë Luftës së Ftohtë, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik investuan në rrjete të fshehta sensorësh nënujore për të monitoruar lëvizjet e nëndetësve bërthamore. Një nga projektet më të njohura ishte SOSUS (Sound Surveillance System), një rrjet gjigant mikrofona nënujorë që u vendos në Atlantik dhe Paqësor për të kapur tingujt e nëndetësve sovjetike. Ky sistem u mbajt sekret për dekada, por më vonë u bë i njohur si një nga arritjet më të mëdha të teknologjisë ushtarake të shekullit XX.

Ky precedent historik tregon se kontrolli i nënujit ka qenë gjithmonë një prioritet strategjik. Ajo që ndryshon sot është shkalla e sofistikimit: nga mikrofonat të thjeshtë akustikë, teknologjia ka kaluar në rrjete të integruara digjitale, dronë autonomë dhe inteligjencë artificiale që analizojnë të dhënat në kohë reale.

Dimensioni ekonomik: Kosto dhe përfitime

Ndërtimi i një rrjeti nënujor është një ndërmarrje kolosale. Çdo sensor, dron apo platformë kërkon investime të mëdha në prodhim, mirëmbajtje dhe integrim. Për shembull, një rrjet i plotë që mbulon një zonë strategjike si Deti i Kinës Jugore mund të kushtojë miliarda dollarë. Megjithatë, përfitimet afatgjata janë të mëdha.

Së pari, këto sisteme ulin kostot e operacioneve tradicionale. Në vend që të dërgohen flota të tëra në patrullim, dronët nënujorë mund të kryejnë të njëjtën punë me shpenzime shumë më të ulëta. Së dyti, ato ofrojnë siguri për infrastrukturën ekonomike globale. Kabllot nënujore të internetit, që mbajnë mbi 95% të trafikut global të të dhënave, janë jetike për ekonominë digjitale. Një rrjet mbrojtës nënujor është një investim jo vetëm ushtarak, por edhe ekonomik.

Në këtë kuptim, teknologjia nënujore nuk është thjesht një shpenzim për ushtrinë, por një garanci për stabilitetin e tregtisë dhe komunikimit global.

Perspektiva rajonale: Mesdheu dhe Ballkani

Edhe pse gara kryesore zhvillohet mes fuqive të mëdha, teknologjia nënujore ka ndikim edhe në rajone më të vogla si Mesdheu dhe Ballkani. Mesdheu është një nga zonat më të ngarkuara me infrastrukturë energjetike dhe kabllot nënujore. Çdo vend që investon në sisteme nënujore fiton një avantazh të madh në mbrojtjen e interesave të tij.

Për vendet e Ballkanit, të cilat nuk kanë flotë të madhe ushtarake, bashkëpunimi rajonal për ndërtimin e rrjeteve nënujore mund të jetë një strategji e zgjuar. Kjo jo vetëm që rrit sigurinë, por edhe forcon rolin e tyre në strukturat euroatlantike. Në këtë mënyrë, teknologjia nënujore nuk është privilegj vetëm i superfuqive, por një mundësi për çdo shtet që kërkon të mbrojë interesat e tij kombëtare.

Një horizont i ri

Nëse Lufta e Ftohtë solli rrjetet e para akustike, epoka digjitale po sjell një revolucion të ri. Integrimi i inteligjencës artificiale, energjisë së rinovueshme dhe komunikimit satelitor po e shndërron nënujin në një hapësirë të kontrolluar dhe të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme. Ky është një horizont i ri për sigurinë globale, ku betejat nuk zhvillohen më vetëm në tokë dhe në ajër, por edhe në thellësitë e oqeanit.

Sistemet nënujore janë një kombinim i historisë, ekonomisë dhe strategjisë. Ato tregojnë se lufta e së ardhmes nuk do të jetë vetëm për territore apo për ajrin, por edhe për hapësirat e padukshme nën sipërfaqe. Ky revolucion i heshtur është një betejë që zhvillohet larg syve tanë, por që mund të përcaktojë ekuilibrin e fuqive në shekullin XXI.



BËHU PJESË E FORCËS REZERVISTE!

Ligji për Forcën Rezerviste ka hyrë në fazën e implementimit.

Çdo shtetas që plotëson kriteret ligjore ka të drejtë të aplikojë për t'u bërë pjesë e **Forcës Rezerviste të Forcave të Armatosura**, duke kontribuar drejtpërdrejt në mbrojtjen dhe sigurinë e vendit.

Forca Rezerviste garanton **mobilizim të shpejtë dhe efektiv** në raste krizash, emergjencash apo nevojash të veçanta kombëtare, duke ofruar një **balancë të qëndrueshme mes jetës civile dhe angazhimit ushtarak**.

❑ **Kush mund të aplikojë?**

Çdo shtetas që përmbush kriteret e përcaktuara me ligj.

❑ **Ku të informoheni?**

➔ Faqja zyrtare e Ministrisë së Mbrojtjes: www.mod.gov.al

➔ **Qendra e Rekrutimit**

❑ Tel: **00355 4 234 8588**

❑ WhatsApp: **+355 68 340 4896**

Forca Rezerviste, shërbe sot për sigurinë e së nesërmes.

Kontribuo për atdheun. Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura.